



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Nr. ____Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

Lënda: Mbi kërkesën për informacion

KOALICIONIT “BASHKË FITOJMË”

Tiranë

Në vijim të kërkesës suaj të datës 12.08.2024, protokolluar me tonën nr. 4481 prot, datë 13.08.2024, nëpërmjet së cilës, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, kërkohet informacion lidhur me angazhimin e nëpunësve civilë në procesin zgjedhor të datës 4.08.2024, në Bashkinë Himarë, ju sqarojmë sa vijon:

- 1- Mbi kërkesën tuaj të parë ku kërkon: *“Listën e personave të caktuar si komisionerë nga Partia Socialiste në 36 QV në Himarë dhe funksionin (pozicionin) e tyre në administratën publike (qendrore apo vendore) të atyre individëve që ishin pesë e administratës deri në 4 Gusht 2024”*, ju bëjmë me dije se:

Departamenti i Administratës Publike është një institucion i krijuar në bazë të legjislacionit për nëpunësin civil. Kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e këtij institucioni janë të përcaktuara në:

- a- Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, sipas të cilave DAP-i:
 - përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave shtetërore në shërbimin civil;
 - përgatit projekt-aktet ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil;
 - mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;
 - përgatit mendim për çdo projekt-akt të propozuar nga institucionet e tjera që ka të bëjë me marrëdhëniet e punësimit në administratën publike;
 - miraton dhe ndjek zbatimin e programeve të trajnimit në shërbimin civil;
 - përgatit planin vjetor të pranimit për institucionet e administratës shtetërore;
 - përfaqëson, së bashku me Ministrinë e Financave, Këshillin e Ministrave në negociatat dhe konsultimet për kushtet e përgjithshme të punës në shërbimin civil me sindikatat ose përfaqësuesit e nëpunësve civilë;
 - administrojnë Regjistrin Qendror të Personelit;
 - mbështet dhe siguron këshillimin e institucioneve në zbatim të këtij ligji;
 - përgatit udhëzime të përgjithshme dhe manuale për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;

- i paraqet Kryeministrit, me propozim të institucioneve të administratës shtetërore, strukturën dhe organikën e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë;
- në përputhje me legjislacionin në fuqi, harton dhe bashkëpunon për strukturën e pagave për nëpunësit dhe punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore;
- harton dhe miraton rekomandimet për politikën e trajnimeve të nëpunësve civilë;
- ushtron çdo kompetencë të dhënë nga ky ligj apo në bazë të tij.

Gjithashtu, po sipas legjislacionit për nëpunësin civil, Departamenti i Administratës Publike (DAP), është njësi përgjegjëse vetëm për institucionet e administratës shtetërore ku përfshihet aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit. Ndërkohë, për institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësi përgjegjëse është njësia e burimeve njerëzore.

- b- Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, sipas të cilave DAP-i:
 - Përgatit projekturdrat e Kryeministrit për strukturat dhe organikat e institucioneve të administratës shtetërore;
 - Jep mendim për çdo akt ligjor dhe nënligjor që miraton krijimin, organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore;
 - Jep mendim për çdo akt ligjor dhe nënligjor që miraton strukturat dhe organikat e institucioneve të administratës shtetërore dhe të institucioneve të pavarura, që miratohen nga organe të tjera të ndryshme nga Kryeministri.
- c- Ligjin nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, sipas të cilit DAP-i përgatit projektaktet ligjore dhe nënligjore për pagat dhe shpërblimet e funksionarëve/nëpunësve/punonjësve të institucioneve të administratës publike, me përjashtim të rasteve kur kjo kompetencë i është dhënë me ligj një organi tjetër.
- d- Ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, sipas të cilit Departamenti i Administratës Publike është organi përgjegjës për marrjen në dorëzim, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit për nëpunësit në shërbimin civil dhe shërbimin diplomatik, si dhe drejtuesit e çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil.

Siç konstatohet nga sa më sipër, DAP-i nuk ka në kompetencë të tij administrimin listës së personave që caktohen si komisionerë në KQV apo në organe të tjera të ngarkuara me administrimin e zgjedhjeve.

Për sa më sipër, DAP-i nuk e disponon informacionin e kërkuar nga ju.

- 2- Mbi kërkesën tuaj të dytë ku kërkohet : “Dokumentacioni që vërteton se këta nëpunës publikë ishin pajisur me autorizim/leje paraprake nga DAP-i për t’u angazhuar në procesin zgjedhor të 4 Gushtit 2024”, ju sqarojmë sa vijon:
- a) Referuar pikës 7, të nenit 6, të Kreut IV, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëpunësi ka të drejtë të angazhohet si komisioner në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar zyrtarisht eprorin direkt dhe njësinë e burimeve njerëzore për këtë veprimtari. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
 - b) Gjithashtu, në zbatim të nenit 47 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpunësi civil ka detyrimin të informojë paraprakisht eprorin e tij për çdo veprimtari me pagesë që kryen jashtë detyrës së tij në shërbimin civil dhe mund të kryejë një veprimtari të tillë vetëm me lejen me shkrim të institucionit.

Pra, detyrimi për dhënien e lejes për angazhimin e nëpunësit civil në këto veprimtari nuk është në kompetencën e DAP-it, por të vetë institucionit përkatës.

Për sa më sipër, DAP-i nuk e disponon informacionin e kërkuar nga ju.

- 3- Mbi kërkesën tuaj të tretë ku kërkoni: “Informacion të detajuar nëse DAP-i ka marrë ndonjë masë administrative për nëpunës të caktuar, lidhur me shkeljen e rregullave sa i takon pjesëmarrjes së tyre në fushatën zgjedhore apo në procesin zgjedhor të mbajtur në datën 4 Gusht 2024 në Himarë”, ju bëjmë me dije se pranë nesh nuk është përcjellë asnjë raportim për angazhimin e nëpunësve civilë në procesin zgjedhor të datës 04.08.2024, në Bashkinë Himarë.

Në përfundim, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor **29**, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t’i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,